

VENDIM
Nr. 296, datë 17.11.2025

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 276, DATË 13.12.2024, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘M.C ENERGJI GOJAN’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘GOJAN’”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, t ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 2871 prot., datë 14.11.2025, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 276, datë 13.12.2024 ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘M.C Energji Gojan’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Gojan’”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “M.C Energji Gojan” sh.p.k.:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 276, datë 13.12.2024, ka licencuar shoqërinë “M.C Energji Gojan” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Gojan”.

- Në pikën 2 të vendimit nr. 276/2024 përcaktohet, se: “Shoqëria duhet të vendosë në punë hidrocentralin brenda datës 28.11.2025”.

- Gjithashtu, në pikën 3 të këtij vendimi përcaktohet, se: “Ky vendim është objekt rishikimi”.

- Sipas raportimeve periodike të ERE-s, mbi të dhënat e tregut të energjisë elektrike, konstatohet se HEC “Gojan” ka hyrë në prodhim në muajin shkurt 2025.

2. Analiza ligjore dhe vlerësimi:

- Shoqëria ka hyrë në prodhim përpara afatit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 276, datë 13.12.2024, duke përmbushur kushtin e vendosur. Për rrjedhojë, ky kusht konsiderohet i realizuar dhe duhet të shfuqizohet.

- Me shfuqizimin e kushtit në pikën 2 të vendimit 276/2025, duhet të shfuqizohet dhe pika 3 e vendimit të lartpërmendur, e cila përcakton se ky vendim është objekt rishikimi në kuadër të plotësimit të kushtit të përcaktuar në pikën 2.

3. Nevoja për ndryshimin e vendimit:

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik, që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se pikat 2 dhe 3 të dispozitivit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 276, datë 13.12.2024, duhet të shfuqizohen, pasi shoqëria “M.C Energji Gojan” sh.p.k. ka përmbushur kushtin përkatës dhe duhet të reflektohet situata aktuale e realizimit të projektit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pikat 2 dhe 3 të vendimit të ERE-s nr. 276, datë 13.12.2024, shfuqizohen.

2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “M.C Energji Gojan” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OST” sh.a. dhe “Alpex” sh.a., lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti